



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

NJOFTIM

**PËR REKRUTIMIN E NJË EKSPERTI TË JASHTËM PËR ASISTENCË DHE
KONSULENCË LIGJORE PËR ANALIZË LIGJORE**

TERMAT E REFERENCËS

Për rekrutimin e një eksperti të jashtëm për asistencë dhe konsulencë ligjore

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në funksion të përmbushjes së detyrave të tij ligjore, si dhe në kuadër të angazhimeve institucionale për përafrimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, vlerëson të nevojshme angazhimin e një eksperti të jashtëm për ofrimin e asistencës dhe konsulencës ligjore.

Ky angazhim synon mbështetjen e AKEP në përgatitjen e një dokumenti analize ligjore mbi detyrimet dhe impaktin e Rregullores së BE-së “Akti i Shërbimeve Digjitale” (Digital Services Act – DSA) në legjislacionin e brendshëm kombëtar.

Objektivi i angazhimit

- Përmbledhje e përgjithshme e Kuadrit të DSA-së;
- Transpozimi i DSA-së në Shqipëri: analizë e boshllëqeve dhe vlerësim i ndikimit;
- Roli i AKEP në rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe roli i AKEP lidhur me zbatimin e DSA;
- Mangësitë ligjore dhe administrative;
- Koordinimi me institucione/organizma të tjera rregullatorë;
- Mbrojtja e konsumatorit nën rregulloren DSA.

Detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertit

Eksperti do të ofrojë asistencë dhe konsulencë ligjore për realizimin e këtyre produkteve

Analiza ligjore e legjislacionit të BE-së

- Hartimi i një dokumenti analize ligjore mbi detyrimet dhe impaktin e Rregullores së BE-së “Akti i Shërbimeve Digjitale” (Digital Services Act – DSA) në legjislacionin kombëtar, duke përfshirë:
 - identifikimin e detyrimeve kryesore të rregullores;

- analizën e përputhshmërisë me legjislacionin ekzistues;
- rekomandime për ndryshime ligjore ose institucionale.

Produktet e pritshme:

Eksperti do të dorëzojë dokument analize ligjore mbi impaktin e Rregullores së BE-së “Digital Services Act (DSA)” në legjislacionin kombëtar.

Të gjitha dokumentet do të dorëzohen në formë shkresore elektronikë dhe në gjuhën shqipe (dhe, nëse kërkohet, edhe në anglisht).

Angazhimi i ekspertit parashikohet të zgjasë **deri në 30 ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës.

Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm:

Eksperti duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare në Drejtësi (në nivel master).
- Përvojë profesionale/ekspertizë të paktën 10 vite në fushën e hartimit të legjislacionit parësor dhe sekondar.
- Njohuri të mira mbi acquis të BE-së në fushën e drejtës publike, rregullimit të tregut ose legjislacionit të BE-së, shërbimeve digjitale dhe të komunikimeve elektronike
- Përvojë të ngjashme në hartim legjislacioni, akte nënligjore, analiza ligjore dhe harmonizim legjislacioni me BE-në.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

Pagesa:

Pagesa do të kryhet në përputhje me kushtet e kontratës dhe pas dorëzimit dhe miratimit të productive përkatëse nga AKEP.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:

1. Diploma e shkollës së lartë dhe master në shkenca juridike;
2. Dokumentacioni që vërteton punë të ngjashme;
3. Fotokopje e librezës së punës që vërteton vitet e eksperiencës;
4. Propozim mbi kushtet financiare për realizimin e kërkesave të thirrjes;
5. Jetëshkrimi;
6. Kopje ID/Pasaportë.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Diploma e shkollës së lartë;	30 pikë
Përvojë profesionale/ekspertizë vërtetuar me dokumentacion përkatës;	40 pikë
Propozim mbi kushtet financiare;	20 pikë
Jetëshkrimi;	10 pikë

Përbën avantazh:

- Kandidatët me përvojë pune mbi 10 vite në fushën e hartimit të legjislacionit parësor dhe sekondar.
- Kandidatët që kanë pjesëmarrje në grupe pune për ekspertizë ose studime në fushën e përafrimit të legjislacionit me atë të BE (të paraqiten referencat përkatëse);

Aplikuesit duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 07 prill 2026, në adresën Rr. Reshit Collaku, pranë zyrës së Arkive– Protokollit, të AKEP.

**KRYETARI
Gentian Sala**